

STATUTI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“DXT” SH.P.K

KAPITULLI I
THEMELIMI, OBJEKTI, SELIA, DHE HAPËSIRA NË INTERNET

Neni 1:Themelimi

(1) Sot, me 15/12/2023 (dymije e njezet e tre), ne mbeshtetje te legjislacionit shqiptar respektivisht ligjit Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”,ne themeluesit, kemi krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin "DXT" shpk

(2) Ortaket themelues i shoqerise jane:

1. znj. Donatella Mongiello, shtetase Italiane, e bija e Giuseppes, lindur me 06.03.1979, në Rome dhe banuese në Via Moschiano, n. 82, Roma, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtese e dokumentit te identifikimit me nr. AV7909943, përfaqësuar me Prokure te Posacme Nr. Rep 3130/ Kol 1130, date 14.12.2023 nga Alma Lanko shtetase shqiptare, e bija e Rako, lindur ne Tirane dhe banuese ne Tirane, lindur me 31.08.1982, madhore dhe me zotersi te plote juridike per te vepruar, mbajtese e leternjoftimit me nr. 036985403 dhe nr. personal I25831125K

dhe

2. znj. Alma Lamko, shtetase shqiptare, e bija e Rako, lindur ne Tirane dhe banuese ne Tirane, lindur me 31.08.1982, madhore dhe me zotersi te plote juridike per te vepruar, mbajtese e leternjoftimit me nr. 036985403 dhe nr. personal I25831125K.

Neni 2: Objekti i veprimtarise

Shoqeria ka si objekt veprimtarie:

- zhvillim dhe mirëmbajtje sistemi software ku përfshihet programimi, kodifikimi;
- Projektim analizim të arkitekturës së sistemeve software, Testim Software;
- Konsulence informatike ne fushen e prodhimit te software.

Shoqëria gjithashtu mund të kryejë, direkt dhe indirekt, të gjitha aktivitetet që përfshihen në objektin e saj si dhe të gjitha aktivitetet plotësuese që lidhen me të; të ndërmarrë të gjitha operacionet tregtare, industriale, ato që lidhen me pasuritë e tundshme, ato të patundshme dhe pasuritë financiare që lidhen me objektin e vetë shoqërisë.

Të gjitha aktivitetet duhet të kryhen në përputhje me ndalimet, kufizimet, kushtet dhe autorizimet e parashikuara në ligj dhe në Statut.

Neni 3: Kohëzgjatja

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike e Shoqerise Tregtare “DXT” sh.p.k eshte e pakufizuar. Ajo mund te shperbehet ne cdo moment, sipas vendimeve te marra nga asambleja e ortakeve.

Neni 4: Selia, hapësira në internet dhe adresa elektronike

(1) Shoqëria e ka selinë ligjore te regjistruar në adresën: Tirane, Njesia Bashkiake nr. 5, Rr. Pjeter Bogdani, Nd. 29, H. 1.



- (2) Shoqëria mund të zhvillojë veprimtarinë e saj ekonomike në të gjithë territorin e Shqipërisë si edhe jashtë saj duke hapur degë dhe/ose zyra përfaqësimi, filiale, agjenci etj. në qendra të tjera administrative në përputhje me legjislacionin e vendeve në të cilat ato hapen.

KAPITULLI II **Kapitali dhe kuotat**

Neni 5: Shumat dhe pagesat e kapitalit themeltar

Kapitali i shoqërisë është 10 000 (dhjete mije) Lekë. Kapitali i shoqërisë ndahet në 2 (dy) kuota të zotëruara nga ortakët e shoqërisë si në vijim:

- **znj.** Donatella Mongiello, zotëron 1 kuote, të barabartë me 80% të pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë;
- **znj.** Alma Lamko, zotëron 1 kuote, të barabartë me 20% të pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë;

Neni 6: Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7: Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.


KREU III **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

Neni 8: Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton cdondryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:



- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- l) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- m) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- n) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- o) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9: Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10: Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11: Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;

- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve
 - e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 12: Përjashtimi nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Neni 13: Administrimi

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

Neni 14: Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15: Përgjegjësia e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

d) të parandalojë dhe mënjanë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

e) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit. Paditë kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesëpadisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.



Kreu IV **Viti financiar-ekspertet**

Neni 16: Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti ipare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17: Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqërise, ate gjithë vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

Kreu V **Prishja –riorganizimi i shoqërisë**

Neni 18: Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqërise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- e) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqërise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese “Shoqëri ne likuidim e siper”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19: Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

Neni 20: Baza Ligjore

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.


Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqërite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqipërise.

Neni 21: Mosmarrëveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te lindre midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

O R T A K E T
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“DXT” shpk

Donatella Mongiello
Perfaqesuar me prokure nga
Alma Lanko



Alma Lamko





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË



NOTER LAURA L. PUSTINA
ADRESA Njesia Administrative n. 5, Rr.
Abdyl Frasheri, P. nr. 31, Ap. 6, kati 3
TEL: 0672020600

PROKURË E POSAÇME

Nr. repertori: 3130

Nr. koleksioni: 1130

Tirane më 14/12/2023

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

* Akti noterial përbehet nga 1 fletë



A2023053330123454014



A2023053330123454014

PROKURË E POSAÇME

Sot, më datë 14.12.2023 /para meje Notere LAURA L. PUSTINA, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Njesia Administrative n. 5, Rr. Abdyl Frasheri, P. nr. 31, Ap. 6, kati 3, u paraqit personalisht:

(I/E) PERFAQESUAR: Donatella Mongiello, atësia Giuseppe, shtetase Italiane, lindur në Rome dhe banuese në Rome, me adresë Via Moschiano, Nr. 82, lindur më 06/03/1979, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Pasaporte Tjeter nr. AV7909943, me te cilen une noterja komunikova personalisht ne gjuhen italiane, ne cilesine e ortakes zoteruese te 80% te pjesemarrjes ne shoqerine ne themelim e siper DXT shpk.

E cila me dëshirë të lirë, vullnet të plotë dhe të pa vesuar, kërkoi nga unë Noterja redaktimin e kësaj prokure të posaçme në bazë të neneve nr. 64, 70 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 62, neni 99 i ligjit 110/2018 “Për Noterinë”, si më poshtë vijon:

“Une nenshkruesja, ne cilesine e siperpermendur, autorizoj znj. Alma Lamko, atësia Rako, amësia Vasilika, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në TIRANË, me adresë Pjetër Bogdani; Nd. 29; H. 1; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 31/08/1982, gjendja civile “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtese e Leternjoftim ID nr. 036985403 dhe nr. personal I25831125K, te ciles i jap te drejte dhe kompetence te plote te realizoje te gjitha veprimet administrative / ligjore per themelimin e shoqerise te se drejtes shqiptare me pergjegjesi te kufizuar, te emertuar DXT shpk, ku une do te jem ortake zoteruese e 80% te pjesemarrjes dhe znj. Alma Lamko zoteruese e 20% te pjesemarrjes, me kapital themeltar 10 000 leke dhe administratore znj. Alma Lamko, duke perfshire edhe te drejten dhe kompetencen per te nenshkruar ne emrin tim te gjitha aktet e nevojshme per themelimin, per te kryer aplikime dhe regjistrimin e shoqerise dhe gjithë cka eshte e nevojshme per regjistrimin e kesaj shoqerie

Kjo prokurë e posaçme është e vlefshme nga momenti i nënshkrimit të saj dhe për një kohë të pacaktuar, deri në mbarimin e saj, me të drejtën e revokimit të saj në çdo kohë.

Të gjitha veprimet e kryera nga përfaqësuesi im i posaçëm brenda tagrave të përcaktuara në këtë prokurë, në mbështetje të të drejtave që më njeh legjislacioni në fuqi në shtetin Shqiptar, do ti konsideroj të drejta e të mirëqena, sikur të ishin kryer prej vetë meje”.

Prokura e Posaçme, u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të të përfaqësuarës, e cila e kuptoi përmbajtjen e saj dhe meqenëse shpreh vullnetin e saj të lirë e të plotë, u njoh dhe i kuptoi efektet e saj juridike, e nënshkroi atë rregullisht përpara meje Noteres.

Kjo Prokurë e Posaçme u hartua në gjuhën Shqipe prej meje Noteres në 3 (tre) kopje, me vlera të njëjta juridike, mbështetur në shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të të përfaqësuarës. Njëra kopje vendoset në arshivën noteriale, kopjet e tjerë për të përfaqësuarën.

Unë Noterja, verifikova identitetin e të përfaqësuarës nëpërmjet dokumentit të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë të neni 62, neni 99 i ligjit 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”, vërtetoj nënshkrimin e saj.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij akti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

(I/E) PERFAQESUAR

Donatella Mongiello

Donatella Mongiello

NOTERE
LAURA L. PUSTINA